

Dr. Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Mbikëqyrës

4 tetor 2022

Të dashura familje të Rajonit Shkollor të Filadelfias,

Është vështirë ta besojmë se kanë kaluar tashmë gjashtë muaj që kur Bordi i Arsimit shpalli emërimin tim si mbikëqyrës më 1 prill 2022. Ditën time të parë në rajon, unë u zotova për një tranzicion në rajon me tri faza. Për fazën 1 dhe gjatë 100 ditëve të mia të para, që ka përfunduar tashmë, unë u zotova që të dëgjoj nga njerëzit anembanë Filadelfias për të mësuar se çfarë bën mirë rajoni, ku ka nevojë për përmirësim dhe se si mund të punojmë në bashkëpunim për të arritur synimet dhe masat mbrojtëse të Rajonit Shkollor të Filadelfias dhe për ta bërë rajonin njërin prej rajoneve shkollore urbane të mëdha me përmirësimin më të shpejtë në vend.

Nëpërmjet 90 sesioneve ku kam mësuar dhe dëgjuar dhe nëpërmjet një pyetësori në internet, kam dëgjuar prej mbi 2.700 prej jush. Dua të falënderoj çdo organizatë që u bë partnere me ne, çdo drejtor shkollor që na mirëpritte dhe çdo qytetar filadelfian që e ngriti zërin lart.

Ja çfarë më thatë ju.

Për sa i përket asaj që rajoni bën mirë, ajo që dëgjova dhe pashë vetë, është se ne kemi shumë arsimtarë dhe staf të cilët janë të fortë, që kanë pasion për punën e arsimit publik dhe të cilët ngrihen çdo ditë dhe punojnë jashtëzakonisht shumë në emër të nxënësve tanë. Kam nder që punoj përkrah tyre.

Përveç stafit dhe atmosferës së shkollës që janë fusha me përparësi të lartë në të cilat duhet të përqendrohemi, ajo që dëgjova më shumë prej jush ishte se:

1. angazhimit dhe komunikimit dypalësh të brendshëm dhe të jashtëm i mungon vazhdimësia dhe transparenca – duke çuar në një krizë të përgjithshme të konfidencës në Rajonin Shkollor;
2. rajoni ka shërbim klientësh të dobët. Kalimi nëpër sistem nganjëherë është i padurueshëm;
3. shumë prej objekteve tona nuk janë të favorshme për mësim; dhe
4. po dështojmë në arrijtjet akademike. Shkallët e zotësisë në shkrim, lexim dhe matematikë janë të papranueshme; dhe shumë prej nxënësve tanë nuk po diplomohen duke pasur aftësitë dhe kredencialet që u nevojiten për të gjetur vende pune me pagë të mirë të cilat ofrojnë mundësi për ndryshimin e jetës dhe ndërtojnë pasuri gjeneratash.

Pra, ja çfarë vjen më pas.

Unë po e rikonstruktuj udhëheqjen e lartë të zyrës tonë qendrore (440) me një përqendrim të menjëhershëm dhe afatgjatë në fushat e akademisë, objekteve të favorshme për mësim, shërbim të klientëve dhe komunikim të përmirësuar, dhe partneritete organizative bazë.

Kështu, jam i gëzuar të shpall emërimin e pesë individëve lokalë në ekipin tim të udhëheqjes ekzekutive të cilët i kam zgjedhur me dorën time për shkak të aftësive të tyre për të na ndihmuar që të përshpejtojmë përpjekjet tona për t'u bërë njëri prej rajoneve shkollore urbane të mëdha me përmirësimin më të shpejtë në vend.

- Uri Monson do të shërbejë tani si Zëvendës Mbikëqyrës i Operacioneve;

- Shavon Savage do të shërbejë në postin e ri si Zëvendës Mbikëqyrës i Shërbimeve Akademike;
- Alexandra Coppadge do të shërbejë si Kryetare e Komunikimit dhe Shërbimit të Klientëve;
- Monique Braxton do të shërbejë si Zëvendës Kryetare e Komunikimit dhe Zëdhënëse e Rajonit; dhe
- Edwin Santana do të shërbejë si Drejtor i Marrëdhënieve me Komunitetin, duke udhëhequr përpjekjet e angazhimit organizativ bazë në komunitet.

Më 20 tetor, unë do të plotësoj fazën 2 të planit tim hyrës, raportin e Ekipit të Tranzicionit. Bashkëkryetarët e Ekipit të Tranzicionit do të paraqesin një raport para Bordit të Arsimit i cili do të përfshijë rekomandime mbarë sistematike, afatshkurtra dhe afatgjata nga pesë nënkomitetet tona që mbuluan arritjet e nxënësve, operacionet, kultivimin e një kulture të drejtë dhe antiraciste, angazhimin në komunitet dhe komunikimin, dhe përvojën shkollore së bashku me hapa veprimi të menjëhershëm. Ju inkurajoj të gjithëve që të vini të enjten, më 20 tetor në mbledhjen e Bordit të Arsimit – ose na ndiqni nëpërmjet PSTV-së – për raportin dhe rekomandimet e Ekipit të Tranzicionit.

Pas këtij raporti, unë do të filloj fazën 3 të planit tim hyrës. Një pjesë e kësaj pune do të përfshijë një vlerësim më të thellë të strukturës tonë organizative dhe zhvillimin e një plani strategjik pesë vjeçar që pres të përfundohet nga fundi i këtij viti shkollor.

Ju ftoj që të vizitoni philasd.org/100days për të parë përmbledhjen e plotë të asaj që qytetarët filadelfianë ndanë me ne gjatë turneut të dëgjimit dhe mësimit dhe për të mësuar më shumë për veprimet që kam vënë në zbatim.

Rajoni ynë shkollor nuk mund ta bëjë këtë punë vetëm dhe ne kërkojmë mbështetjen dhe bashkëpunimin e gjithësecilit në këtë qytet të madh historik të Filadelfias për të na ndihmuar që të ndërtojmë një sistem arsimit i cili i përgatit fëmijët tanë për mundësi për ndryshimin e jetës dhe rezultate në jetë dhe botën e punës. Fëmijët tanë nuk meritojnë asgjë më pak se kaq.

Le ta ndërtojmë së bashku këtë premtim.

Në partneritet për fëmijët,



Tony B. Watlington Sr., Ed.D.

Mbikëqyrës

Rajoni Shkollor i Filadelfias